# ANTICA CALCE ELITE

BOJË MINERALE E TRADITËS ITALIANE PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME- JASHTME

**seri 930**

## PËRSHKRIMI

ANTICA CALCE ELITE është finiturë murale për sipërfaqe të jashtme dhe të brendshme, me bazë lidhës mineralë të modifikuar me shtues organikë. Shumë transpirante, absorbim I ulët I ujit, riprodhon efektin tipik opak të dekorimeve antike në gëlqere. Produkti teksa aplikohet rezulton lisho në prekje, opak dhe I pasur me dritëhije të buta.

ANTICA CALCE ELITE lejon dekorimin e cdolloj sipërfaqeje me një gamë të gjerë ngjyrash, duke riprodhuar stilin e punimeve antike në gëlqere të traditës italiane, ideale për restaurimin e sipërfaqeve historike dhe kontemporane.

## INSTRUKSIONE PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:

-Suvatime të reja dhe të vjetra.

-Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.

-Sipërfaqe me natyrë minerale me kusht që të jenë absorbuese.

Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin “Përgatitja e sipërfaqes”.

Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta (të sapo suvatuara).

## KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-Natyra e lidhësit: Gëlqere ajrosëse

-Lidhësit organike: <5%

-Klasifikimi I cilësise së ajrit për brenda: A+

-Klasifikimi UNI EN 1062-1: (bojë për jashtë)

.Shkëlqimi EN ISO 2813: klasi G3 (<10, opake)

.Trashësia e filmit të tharë ISO 3233: klasi E2 (50-100 µm)

.Granulometria EN ISO 1524: klasi S1 (<100 µm fine)

.Shkalla e transmetimit të avujve të ujit UNI EN ISO 7783-2: klasi V1 (Sd<0,14 m e lartë) Sd≤0,10 m për trashësi prej 0,6 mm.

.Përshkueshmëria e ujit UNI EN 1062-3: klasi W2 (0.1-0.5)

.Rezistenca ndaj carjeve UNI EN 1062-7A: klasi A0 (nuk aplikohet)

.Përshkueshmëria e $CO_2$ UNI EN 1062-6: klasi C0 (nuk aplikohet)

Karakteristika të tjera

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,28 ± 0,05 kg/l

-Viskoziteti I paketimit UNI 8902: 4000 ± 1600 cps ne 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield)

-Tharja (a 25 °C e 65% di U.R.): prekja në 30 minuta; shtresa tjetër pas 4 orësh.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e maturuar mirë për një periudhë kohe prej të paktën 28 ditësh.

-Kontrolloni gjendjen e konservimit të sipërfaqes. Sipërfaqja duhet të jetë e konsoliduar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.

-Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me restauruesin COMBAT 333 kod. 4810333

-Hiqni,me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe pluhurat e bojës së vjetër.

-Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës traspirante/tempera.

-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.

-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, çarjet në sipërfaqje me TAMSTUCCO 9400006 ose TAMSTUCCO POLVERE 9410110 ; në sipërfaqet e jashtme preferohet që të bëhen nivelime me produkte të të njëjtës natyrë me suvanë aktuale ose me BETOMARC 9450150 ose me RASAMIX 9440160.

-Çarjet,si brenda edhe jashtë, duhet të zgjerohen sa duhet dhe të mbushen me stuko ose produkte analoge/ngjashme.

-Zmeriloni stukimet me letër zmerile.

-Vetëm në sipërfaqet veçanërisht me pluhur aplikoni nje shtresë astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.

-Në prani të sfondeve johomogjene, me bojra të vjetra organike ose minerale, stukimeve, çarjeve, uniformoni sipërfaqjen paraprakisht nëpërmjet aplikimit të MARCOSIL GRIP 9310019.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë, dmth para aplikimit të ANTICA CALCE ELITE Sipas udhëzimeve të dhëna në instruksionet për aplikim

* (Hollimi I astarit dhe sasia për t’u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqje specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

## UDHËZIME PËR APLIKIM

-Pas tharjes dhe karbonatizimit të ANTICA CALCE ELITE, si për të gjithë produktet me bazë gëlqere të cilët influencohen shumë nga

Fraldi Shpk

kushtet e temperaturës dhe lagështires, këshillohet të aplikohet me temperaturë ndërmjet +10°C dhe +35°C dhe me lagështirë relative të ambientit <75%.

-Shmangni aplikimet në sipërfaqe që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të diellit.

-Ekspozimi ndaj agjentëve atmosferikë, shiu, lagështira e lartë, temperatura ambientale e ulët, të sipërfaqeve të trajtuara me finiturë në gëlqere, mund të gjenerojë fenomene të zbardhjes së finiturës gjatë procesit të karbonatizimit. Fenomene të tilla mund të jenë të pakthyeshme në kushte veçanërisht ekstreme.

-Pas aplikimit, sipërfaqet e jashtme duhet të jenë të mbrojtura nga shiu dhe lagështira deri në tharjen komplet të produktit që normalisht (në 20°C) arrihet pas rreth 72 orësh.

-Mjetet: pinel, rrul dhe furcë.

-Në shtresën e fundit të finiturës (përfundimtare) është e mundur të krijohen efekte kromatike, të ndryshme, dekorative duke përdorur një sfungjer.

-Nr I shtresave: të paktën 2 shtresa.

-Hollimi: shtresa e parë 25-30% me ujë; shtresat e tjera 15-20%.

-Pastrimi I mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.

-Shkalla e mbulimit: 8-10 $m^2$/l për shtresë, I referohet sipërfaqeve lisho dhe mesatarisht absorbuese. Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

## NGJYROSJA

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit tintometrik Marcromie dhe koloranteve rezistente ndaj alkaleve COLORADO seri 548. Në rastin e përdorimit të prodhimve të ndryshme, këshillohet përzierja e tyre për të shmangur ndryshime të vogla në tonalitete. Në ndërhyrjet për jashtë ne rekomandojmë që të përfundoni punimin me materiale të të njëjtit prodhim. Për punë, në të cilat është i pashmangshëm përdorimi i një materiali të ri, mos e aplikoni afër materialit te përdorur më parë. Për rakordimin përdorni ndërprerjet e vazhdimësisë së sipërfaqes, kolonave, mbulesave, skajeve, kabllove ose të tjera.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/a: bojë opake për mure dhe tavane të brendshëm (shkëlqim <25@60°) (bazë uji): 30 g/l (2010)
Kat. A/c: bojë për mure të jashtëm të sipërfaqeve minerale (bazë uji): 40 g/l (2010)
ANTICA CALCE ELITE
Përmban max: 30 g/l VOC
Shkakton dëme të rënda okulare. Shkakton irritim të lëkurës. Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe të mbahet stok sipas normave aktuale të higjienës dhe siguris; I lini të thahen mbetjet dhe I trajtoni ato si mbetje të vecanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Bojë minerale,për sipërfaqe të jashtme-brendshme.
Aplikimi, në sipërfaqe të predispozuara për finitur murale me bazë lidhës minerale të modifikuar me shtues organikë, shumë transpirante dhe me absorbim të ulët të ujit ANTICA CALCE ELITE seri 930. në të paktën 2 shtresa, në sasinë e caktuar nga absorbimi I sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € ................ për $m^2$.

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperienca e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*